



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 952 prot.

Gramsh, më 10/03/2021

VENDIM

Nr. 42, datë 10.03.2021

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2021

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr.108, datë 05.03.2014 “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil, pika 2,3 dhe 11,13, me propozim të drejtorisë së burimeve njerëzore,

VENDOSA:

1. Të miratojë Planin e Pranimit për vitin 2021 në shërbimin civil të administratës së Bashkisë Gramsh sipas Tabelës bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, prej 50 (pesëdhjetë) pozicioneve të shërbimit civil, nga të cilët:
 - a. 1(një) pozicion të kategorisë I, klasa I-b, niveli i lartë drejtues;
 - b. 1(një) pozicion të kategorisë II, klasa II-b, niveli mesëm drejtues;
 - c. 10 (dhjetë) pozicione të kategorisë III-a, klasa III-a/1, niveli i ulët drejtues;
 - d. 4 (katër) pozicione të kategorisë IV, klasa IV-a, niveli ekzekutiv;
2. Plani prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) pozicioneve të shpallet në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Web-n e Bashkisë dhe stendën e afishimeve publike të Bashkisë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Pas shpalljes publike, nga Njësia Përgjegjëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të nisnin procedurat për shpalljen e vendeve të lira dhe brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh procedurat e pranimit në shërbimin civil, nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë për:
 - a. 1(një) pozicione të nivelit të lartë drejtues:
-Sekretar i Përgjithshëm;
 - b. 1(një) pozicione të nivelit të mesëm drejtues;

-Drejtor i drejtorisë së shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehim dhe emergjencave civile;

c. 10(dhjetë) pozicione të nivelit të ulët drejtues:

-Përgjegjës i Sektorit për Koordinimin e Integritetit Europian, Ndhmës së Huaj dhe Turizmit; -Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit; -Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve me Sipërmarrje dhe Mjedisit; -Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore; -Përgjegjës i Sektorit të Arkivës; -Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave; -Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Burimeve Natyrore; -Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore; -Përgjegjës i Sektorit të IT; -Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve me Një Ndalesë;

d. 4 (katër) pozicione të nivelit ekzekutiv:- Specialist auditimi i brendshëm (i pacertifikuar); -Specialist për kontrollin e zhvillimit dhe investimet; -Specialist i ndihmës ekonomike; -Specialist për mbrojtjen e mjedisit, burimeve natyrore, lejeve dhe licensave;

Për nivelin ekzekutiv, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të zhvillojë procedurat për pranimin në shërbimin civil nëpërmjet lëvizjes paralele dhe pranimit për herë të parë në shërbimin civil.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Komisionet përkatëse për Lëvizjen Paralele, Ngritjen në Detyrë dhe Pranimin në Shërbimin Civil.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

P/Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Joana Zani

KRYETARI

Klodian TAÇE



Konceptoi: J. Llapushi
Pranoi: J. Zani
Miratoi: A. Shani
Konfirmoi: -/-
Afati i ruajtjes: RTHK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 952/11 prot.

Gramsh, më 10/03 /2021

PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL

BASHKIA GRAMSH 2021

Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr.108, datë 26.02.2014 ‘Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil’, pika 2,3 dhe pika 11,13, janë identifikuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) vende të lira, për vitin 2021, pozicione sipas kategorisë, klasave, niveleve e grupeve në tabelën vijuese,

Nr. kategoria	Emërtimi i kategorisë/klasës	Plani i pranimit viti 2021			
		Gjithsej	Pension	vend i ri	vakant
I-b	NC niveli i larte drejtues (klasa I)	1	-	-	1
II-b	NC niveli i mesem drejtues(klasa II)	5	1	-	1
III-a/1 III-b	NC niveli i ulet drejtues (klasa III)	16	-	1	10
III-b	NC kategoria ekzekutive (specialist) (klasa IV)	28	-	-	4
TOTALI		50	1	1	16

P/Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Joana Zani

KRYETARI

Klodian TAÇE



Konceptoi: J. Llapushi
Pranoi: J. Zani
Miratoi: A. Shulli
Konfirmoi: -/-
Afati i ruajtes: RHK